

VENDIM
Nr. 84/2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 86/2018, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 37, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; me propozimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- II. Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
- III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 23.12.2020

ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/klasa
I. Komisioneri	1	I-D Ligji nr. 9584, datë 17.7.2006, i ndryshuar
II. Kabineti	(3)	VKM-ja nr. 187, datë 8.3.2017
Drejtor	1	II-a
Këshilltar	1	II-b
Zëdhënës	1	II-b
III. Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit		(10)
Drejtor i Përgjithshëm	1	II-a
III/I Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës		
Drejtor	1	II-b
Inspektor	3	III-a
III/II Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave		
Drejtor	1	II-b
Inspektor	4	III-a
IV. Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale		(12)
Drejtor i Përgjithshëm	1	II-a
IV/I Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit		
Drejtor	1	II-b
Inspektor	4	III-a
IV/II Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave		
Drejtor	1	II-b
Inspektor	5	III-a
V. Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritimit		(7)
Drejtor	1	II-b

V/I Sektori Rregullator, i Integritetit dhe Procedurave Administrative		
Shef sektori	1	III-a
Inspektorë	2	III-a
V/II Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë		
Shef sektori	1	III-a
Specialistë	2	III-b
VI. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës		(11)
Drejtor	1	II-b
VI/I Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun		
Shef sektori	1	III-a
Specialist IT	1	III-b
Specialist i burimeve njerëzore/analist i punës	1	III-b
Specialist për marrëdhënieve me publikun	1	III-b
Nëpunës informacioni	1	Kl. III (VKM-ja nr. 717, datë 23.6.2009, e ndryshuar)
VI/II. Sektori i Shërbimeve dhe Financës		
Shef sektori (pers. përgj. prokurimet)	1	III-a
Specialist financë – buxhet/shërbime	1	III-b
Specialist redaktor/protokoll/arkiv	1	IV-a
Magazininier/shofer	1	Kl. VI (VKM-ja nr. 717, datë 23.6.2009, e ndryshuar)
Punonjës pastrimi	1	Kl. I (VKM-ja nr. 717, datë 23.6.2009, e ndryshuar)
Gjithsej	44 punonjës	

